

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë



Plani strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2016-2018

maj 2015

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14) dhe neni 12 paragrafi 6 të Rregullores për planifikim Rr. nr. 02-15/VIII-2/2013 nga 1 gusht i vitit 2013, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi:

Planin strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2016-2018

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Planin strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) përcaktohet në bazë të misionit, vizionit dhe vlerave organizative të Bankës Popullore, në varësi nga mjedisi makroekonomik dhe sfidat kryesore të periudhës së ardhshme dhe përmban qëllimet kryesore strategjike për periudhën e ardhshme tre vjeçare.
2. Planin strategjik rishikohet çdo vit dhe paraqet bazë për përgatitjen e programit për punë, me të cilën përcaktohen programet vjetore për realizimin e qëllimeve strategjike.

II. MANDATI DHE KOMPETENCAT

3. Qëllimet kryesore të Bankës Popullore janë të përcaktuara në Ligjin për Bankën Popullore, sipas së cilit qëllimi kryesor i Bankës Popullore është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Qëllim tjetër, në varësi të qëllimit kryesor është që ajo të kontribuojë në ruajtjen e sistemit stabil financiar, konkurrues dhe të orientuar kah tregu, ndërsa qëllim i tretë është përkrahja e Bankës Popullore në politikën e përgjithshme ekonomike pa e rrezikuar realizimin e qëllimit kryesor dhe në pajtueshmëri me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë.

III. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT

4. **Misioni** rrjedh nga qëllimet e përcaktuara me ligj dhe paraqet përkushtimin e Bankës Popullore për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve duke zbatuar strategjinë e zgjedhur monetare të ruajtjes së kursit stabil të denarit në raport me euron. Gjithashtu, Banka Popullore do të vazhdojë të jep kontribut lidhur me ruajtjen e stabilitetit financiar dhe rritjen e mirëqenies ekonomike dhe standardit jetësorë të qytetarëve.
5. **Vizioni** i Bankës Popullore është që ajo të njihet si një institucion i pavarur, i përgjegjshëm, profesional dhe transparent dhe që gëzon besim të lartë dhe kredibilitet në opinion.
6. **Vlerat** kontribuojnë në arritjen e misionit dhe e përkrahin vizionin e Bankës Popullore, nëpërmjet forcimit të kulturës organizative, rritjes së efektivitetit në punë, rregullimi i

marrëdhënieve ndërmjet punëtorëve, zhvillimi i përgjegjësisë dhe vetëdijesimit për detyrat e punës dhe krijimin e një mjedisi pozitiv që siguron motivim dhe kënaqësi tek të punësuarit.

Banka Popullore edhe më tej do t'i nxisë dhe do t'i ruaj vlerat në vazhdim:

Kualitet - realizimi i qëllimeve dhe pritshmërive të të punësuarve, dhe të personave fizik dhe juridik të vendit dhe të jashtëm, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve të punës, në pajtueshmëri me praktikën më të mira ndërkombëtare;

Integritet - sigurimi i konsistencës, saktësisë dhe ndershmërisë gjatë realizimit të qëllimeve dhe aktiviteteve;

Lojalitet (Besnikëri)- dhënia përparësi realizimit të interesave të Bankës Popullore në raport me interesat e individëve ose grupeve dhe përkushtimi për arritjen e misionit, vizionit dhe qëllimeve strategjike të institucionit;

Transparenca – sigurim të informimit të saktë dhe në kohë të të punësuarve dhe personave fizik dhe juridik të vendit dhe të jashtëm lidhur me vendimet dhe masat e Bankës Popullore;

Udhëheqja (Leadership) - mbështetje tek ambiciet e shëndosha, intelekti dhe vetë disiplina e ndërtuar në bazë të besimit të ndërsjellë tek të punësuarit;

Inovacionet - stimulimi i inovacioneve, përmirësim i qëndrueshëm dhe të menduarit kritik; Profesionalizmi- Vlerësime të shëndosha dhe kapacitet i lartë intelektual;

Puna në ekip (Shpirti i ekipit) - sigurimi i sinergjisë dhe kultura e shpërndarjes së dijes dhe puna në ekip.

IV. MJEDISI MAKROEKONOMIK DHE SFIDAT KRYESORE

7. Gjatë periudhës së ardhshme, Banka Popullore do të punojë me tërë kapacitetin e saj për realizimin e qëllimeve të caktuara me ligj.

Sikurse në disa vite të kaluara, ambienti në të cilin do të realizohen qëllimet strategjike të Bankës Popullore është në shenjë e pritshmërive të rimëkëmbjes së ekonomisë globale post-krizës. Megjithatë, edhe më tej shihet pasiguria, ndjeshmëria në segmente të caktuara dhe rreziqe jo të favorshme dhe me të edhe mundësi për kthesa jo të favorshme. Domethënë, pavarësisht stabilizimit gradual të rrjedhave ekonomike financiare në kornizë globale, sfida kryesore pas ndërmarrjes së masave fiskale dhe monetare, paraqet rimëkëmbja ekonomike, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e sektorit financiar dhe financave publike tek një numër më i madh i vendeve. Ky konstatim ka të bëjë kryesisht me zonën e euros, si partner ekonomik i rëndësishëm i yni, ku rreziqet për prolongim të rritjes së dobët ekonomike dhe deflacionit, edhe pse të zvogëluara me masat e fundit të ndërmarra nga banka qendrore evropiane, përsëri ekzistojnë edhe më tej. Në periudhën e kaluar u bënë më të dukshme edhe rreziqet që lidhen me çmimet e produkteve primare, dinamika dhe pritshmëria e së cilave për drejtimin e tyre në të ardhmen shpesh ndryshon nën ndikim të faktorëve ekonomik dhe gjeopolitik.

Në periudhën e ardhshme, inflacioni i ulët dhe stabiliteti i valutës vendase do të vazhdojë të jetë karakteristikë kryesore e ekonomisë së vendit, duke marrë parasysh pritjet për rritjen stabile të mbështetjes së kredisë dhe rritjes solide të ekonomisë. Në kushte të tilla, rreziqet kryesore lidhur me zbatimin e politikës monetare, në periudhën e ardhshme janë perceptuar në

lidhje me pasigurinë rreth hyrjeve të ardhshme të kapitalit të huaj në ekonominë e vendit, ku në rast të zhvillimeve jo të favorshme mund të imponojë nevojën për reagim efikas duke shtrënguar kushtet monetare. Nga ana tjetër, likuiditeti i tepërt në euro - zonë dhe rendimentet e ulëta të tregjeve financiare evropiane, mund të kenë efekt pozitiv në drejtim të rritjes së fluksit të hyrjeve të kapitalit të huaj në ekonominë e vendit. Lëvizjet e tilla do të përcaktojnë përshtatje e qëndrimit operativ të politikës monetare, në drejtim të tërheqjes efikase të tepricave eventuale të mjeteve të likuiditetit.

Menaxhimi i rezervave valutore do të realizohet në përputhje me kushtet e brendshme dhe ndërkombëtare, duke respektuar parimet e sigurisë, likuiditetit dhe profitabilitetit. Në këtë kontekst, me qëllim që të sigurojë ekuilibër optimal midis kthimit dhe rrezikut të investimit, parashihet përshtatje e strategjisë së investimeve në drejtim të rritjes së investimeve në instrumente financiare dhe valuta me rendimente pozitive dhe pamje më stabile ekonomike.

Zbatimi i politikës monetare në një ekonomi shumë të hapur e cila është duke kaluar nëpër procesin e reformave strukturore, është një detyrë relativisht komplekse. Mjedisi i jashtëm dinamik, rreziqet shoqëruese dhe ndikimi i tyre i mundshëm në ekonominë e vendit, imponojnë nevojën për zhvillimin e vazhdueshëm të punës analitike dhe kërkimore, zhvillim të procesit të parashikimit dhe të modelimit dhe rritjen e kapaciteteve për zbulimin në kohë të rreziqeve potenciale, perceptimin e zhvillimeve dhe ndryshime të ardhshme në mjedis. Hulumtimet do të mundësojnë kuptim më të mirë të efekteve të transmetimit të politikës monetare, ndjekjen e zhvillimeve në ekonominë reale dhe analizë të lidhjeve makro financiare, që janë të një rëndësie të madhe për vendosje efektive dhe zbatim të politikës monetare.

Duke pasur parasysh objektivin ligjor për ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar dhe financiar, do të vazhdojnë aktivitetet për forcimin e mbikëqyrjes bankare. Në periudhën e ardhshme pritet që kapitalizimi dhe likuiditeti i kënaqshëm të mbeten anët më të fuqishme të sistemit bankar në vend. Një sfidë të rëndësishme paraqet menaxhimi me pjesën problematike të portofolios së kredive tek bankat, si dhe krijimin e kushteve për të gjeneruar profitabilitetit të kënaqshëm dhe të qëndrueshëm. Gjithashtu, duke ndjekur trendet globale, më shumë vëmendje do t'u kushtohet bankave me rëndësi sistemike, si dhe përshtatjes graduale kah standardet e reja bankare ndërkombëtare dhe praktikave mbikëqyrëse. Banka Popullore do të vazhdojë që të përmirësojë dhe të thellojë analizat për sistemin bankar, stabilitetin e tij dhe rezistencën ndaj goditjeve si dhe stabilitetin e përgjithshëm financiar në vend.

Në një periudhë të ardhshme afatmesme, Banka Popullore do të vazhdojë të zhvillojë dhe të promovojë regjistrimin financiar dhe raportimin, e cila do të mundësojë menaxhim më efikas me financat, planifikimin dinamik dhe monitorimin e bilancit të Bankës Popullore. Kontrolli i shpenzimeve, arritja e kthimit nga investimet financiare me rrezik më të ulët të ekspozimit dhe optimizimit të të ardhurave nga puna e rregullt, do të jenë shtylla kryesore e angazhimit të Bankës Popullore.

Në pjesën e sistemeve të pagesave, sfidë kryesore është krijimi i sistemit për pagesa ndërkufitare në euro nëpërmjet sistemit RTGS (MIPS) të BPRM-së. Infrastruktura e re e pagesës do të rrisë efikasitetin gjatë kryerjes së pagesave jashtë vendit, që sjell përfitim për tërë ekonominë.

Në fushën e statistikës, periudha e post-krizës u shënua nga rritja e vetëdijes për nevojën për kualitet, të dhëna makroekonomike më të detajuara dhe në kohë si dhe përmirësimin e mënyrës së paraqitjes së të dhënave statistikore para opinionit më të gjerë. Që andej, edhe fokusi i afatit të mesëm do të jetë në këto segmente. Gjithashtu, duke pasur parasysh angazhimin e Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në BE, sfidë kryesore mbetet arritja graduale e kërkesave të BE-së në lidhje me mbulimin dhe kualitetin e statistikave makroekonomike.

Realizimi i qëllimeve strategjike kërkon monitorim aktiv të tendencave në veprimtarinë e bankave qendrore, forcim të mëtejshëm të kapacitetit institucional si dhe avancim dhe zhvillim të kapitalit njerëzor. Aktivitetet e përhershme për njohjen në kohë dhe menaxhim efektiv me rreziqet në punën operative, do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve më të mira në punë dhe gatishmëri më të madhe për t'u përballur me sfidat në të ardhmen.

V. QËLLIMET STRATEGJIKE TË BANKËS POPULLORE

8. Banka Popullore do të jetë e drejtuar kah realizimi i misionit dhe vizionit përmes realizimit të qëllimeve strategjike të mëposhtme:

Qëllimi strategjik 1

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve nëpërmjet kursit stabil të denarit kundrejt euros.

Qëllimi strategjik 2

- Ruajtja e sistemit stabil dhe të sigurt bankar, si parakusht themelor për stabilitetin financiar dhe rritje të qëndrueshme ekonomike të vendit.

Qëllimi strategjik 3

- Menaxhimi efikas me rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë, përgjatë një ekuilibri optimal të parimeve të sigurisë, likuiditetit dhe kthesës nga menaxhimi.

Qëllimi strategjik 4

- Mbështetje e zhvillimit të tregjeve financiare të vendit.

Qëllimi strategjik 5

- Rritja e efikasitetit të sistemit për furnizim dhe përpunim të kartëmonedhave dhe monedhave dhe rritja e kualitetit dhe funksionalitetit të parave të gatshme në qarkullim.

Qëllimi strategjik 6

- Ruajtja e shkallës më të lartë të sigurisë, stabilitetit dhe efikasiteti të sistemeve të pagesës në vend dhe sigurimin e kushteve për lidhje ndërkufitare të sistemeve të pagesës.

Qëllimi strategjik 7

- Zhvillimi i veprimtarisë hulumtuese në fushat që janë të një rëndësie të madhe për realizimin efikas të qëllimeve të Bankës Popullore.

Qëllimi strategjik 8

- Sigurimi i të dhënave kualitative statistikore, në përputhje të plotë me standardet statistikore ndërkombëtare dhe evropiane, duke marrë parasysh peshën e raportimit dhe përhapjen e tyre efikase, në kohë dhe të lehtë për përdoruesit.

Qëllimi strategjik 9

Përgatitja e Bankës Popullore për bashkim dhe anëtarësim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Qëllimi strategjik 10

- Ndjekja e tendencave të veprimtarisë së bankave qendrore, forcimin e fleksibilitetit në raport me ndryshimet që i imponon mjedisi, menaxhimit efektiv i rreziqeve në të gjitha segmentet e punës, përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë sociale të institucionit.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

9. Plani hyn në fuqi në ditën e miratimit, ndërsa do të zbatohet nga 1 janari i vitit 2016.

10. Me fillimin e implementimit të këtij plani, Planit Strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë PS.nr. 02-15/VI-1 / 2013 nga 30 maj të vitit 2013 shfuqizohet.

P.S.Nr.02-15/V-1/2015

7 maj 2015

Shkup

**Guvernator
dhe Kryetar i
Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov**